



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA GRAMSH  
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr \_\_\_\_\_ prot

Gramsh, më 17/08/2020

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**

Data 17.08.2020

Për: Operatorin Ekonomik - "Ina" sh.p.k

Adresa: Rruga Besim Imami, Myslym Shyri, Mbrapa Karburantit, Tiranë

Procedura e prokurimit: "Kërkesë për propozime", me mjete elektronike

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-63206-06-29-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: "Ndërtimi i varrezave të qytetit", me afat 75 ditë nga data e lidhjes së kontratës.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike 06/07/ 2020 [Nr. 41]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X**, oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

\* \* \*

1. **Shoqëria - "2Z Konstruksion" sh.p.k**, me nr.Nipti J63229466K me vlerë të ofertës 7 380 420 (shtatë milionë e treqind e tetëdhjetë mijë e katërqind e njëzetë) lekë, pa TVSH.
2. **Shoqëria- "Fled" sh.p.k**, me nr.Nipti K17621104C me vlerë të ofertës 5 561 730 (pesë milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e shtatëqind e tridhjetë) lekë, pa TVSH.
3. **Shoqëria- "Ina" sh.p.k**, me nr.Nipti J61814009W me vlerë të ofertës 6 056 240 (gjashtë milionë e pesëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e dyzetë) lekë, pa TVSH.
4. **Bashkimi i Operatorëve ekonomikë - "Jogi" sh.p.k & "General Beton" sh.p.k**, me nr.Nipti J63229478K & K23013401A me vlerë të ofertës 6 565 910 (gjashtë milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e dhjetë) lekë, pa TVSH.
5. **Shoqëria- "Spektri" sh.p.k**, me nr.Nipti J62903555F me vlerë të ofertës 5 993 370 (pesë milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tremijë e treqind e shtatëdhjetë) lekë, pa TVSH.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm :

**1. Shoqëria- "2Z Konstruksion" sh.p.k, për arsyet :**

Nga ana e Komisionit të Vleresimit të Ofertave konstatohet se ky OE **nuk** ka dorëzuar në SPE gjithë dokumentacionin lidhur me kualifikimin tekniko-ligjor të kerkuar në Kriteret e Përgjithshme dhe të Vecanta të Kualifikimit të pershkuara në DST, si më poshtë:

- Nuk ka dorëzuar vërtetimin e xhiros për 3 vitet e fundit të lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore.
- Nuk përmbush kriterin për një inxhinier hidroteknik cili të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të figurojë në listë pagesat e shoqërisë 3-muajt e fundit. Ka dorëzuar dokumentacion për një ing. hidroteknik A.D i cili nuk figuron në licensën e shoqërisë dhe as në listë pagesa në kundërshtim me pikën 2.3.5 të Kriterëve të Vecanta të

Kualifikimit .

- Nuk ka dorëzuar dokumentacion për një Gjeodet/Topograf /Markshajder i cili të figurojë në licensën e shoqërisë dhe të figurojë në listë pagesat e shoqërisë 3-muajt e fundit në kundërshtim me pikën 2.3.5 të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit.
- Nuk ka dorëzuar dokumentacion për një karpentier,elektriçist dhe murator në kundërshtim me pikën 2.3.8 të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit
- Nuk ka dorëzuar dokumentacion për 2 (dy) eskavatoristë dhe 4 (katër)automakinistë,ka dorëzuar dokumentacion vetëm për 1(një) eskavatorist dhe 1(një)automakinist , në kundërshtim me pikën 2.3.9 të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit
- Nuk përmbush kriteret e përcaktuara në DST ,lidhur me kapacitetin mbajtës për kamionin 10-15 ton si dhe për 2 kamionçina me kapacitet mbajtës 3.5-5 ton. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE),rezulton se është paraqitur dokumentacion si më poshtë: Kamionçinë me targa AA692 GI me kapacitet mbajtës nën 3.5 ton si dhe mungon foto e mjetit; Kamionçinë me targa FR 6168 D me kapacitet mbajtës nën 3.5 ton; Kamionçinë me targa AA 472 HS me kapacitet mbajtës nën 3.5 ton si dhe mungon foto e mjetit; Kamionçinë me targa FR 1719 D për të cilën mungon fotoja e mjetit; Kamionçinë me targa AA842XT me kapacitet mbajtës nën 3.5 ton si dhe mungon fotoja e mjetit,mungon siguracioni i vlefshëm (afati i vlefshmërisë 02.07.2020) si dhe kolaudimi i vlefshëm(afati i vlefshmërisë 02.07.2020); ATP me targa AA 926 GF me kapacitet mbajtës nën 3.5 ton si dhe mungon siguracioni i vlefshëm (afati i vlefshmërisë 08.07.2020) si dhe kolaudimi i vlefshëm(afati i vlefshmërisë 08.07.2020); Kamionçinë me targa AA 857 KG me kapacitet mbajtës nën 3.5 ton ; Kamion me targa FR 5370 D me kapacitet mbajtës nën 10 ton; Kamion me targa AA 621 SA me kapacitet mbajtës mbi 15 ton; Kamion me targa AA 108 NE me kapacitet mbajtës mbi 15 ton; Kamion me targa AA 233 PV me kapacitet mbajtës mbi 15 ton; Kamion me targa AA 689 OI me kapacitet mbajtës mbi 15 ton;Kamion me targa AA403 DL me kapacitet mbajtës nën 10 ton për të cilin mungon siguracioni i vlefshëm (afati i vlefshmërisë 16.06.2020) si dhe kolaudimi i vlefshëm(afati i vlefshmërisë 25.06.2020) ; Për mjetin MT me targa ACMT50 mungon siguracioni i vlefshëm (afati i vlefshmërisë 19.05.2020) si dhe kolaudimi i vlefshëm(afati i vlefshmërisë 27.05.2020); Për eskavatorin me goma me targa AGMT02 mungon foto; Për autobotin e ujit me targa AA207 IY mungon çertifikata e pronësisë. Asnjë nga mjetet e deklaruara nuk përmbush kapacitetin prej 10-15 ton për kamionin dhe 3.5-5 ton për kamionçinat,po kështu nuk përmbushet kriteri për fadromën me goma.Si përfundim ky kriter konsiderohet i papërmbushur.

## 2. Shoqëria- “Fled”sh.p.k, për arsyt :

Nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave konstatohet se ky OE **nuk** ka dorëzuar në SPE gjithë dokumentacionin lidhur me kualifikimin tekniko-ligjor të kerkuar në Kriteret e Përgjithshme dhe të Vecanta të Kualifikimit të pershkruara në DST,si më poshtë:

- Nuk ka dorëzuar diplome/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore,për 1(nje) punonjës hidraulik, 1 (nje) punonjës elektrikist ,1 (nje) punonjës karpentier ,1 (nje) punonjës murator.Ka dorëzuar kontratë pune të vlefshme, , dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve,në kundërshtim kjo me pikën 2.3.8 të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit.
- Në pikën 2.3.12 të të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit është kërkuar:

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
---------------	--------------	----------------

Kamion me kapacitet mbajtës 10 - 15 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
---	--------	---------------------

Për të përmbushur këtë kriter operatori ekonomik “Fled” shpk ka dorëzuar dokumentacion për mjetin me targa AA886HG me kapacitet mbajtës 7.4 ton, AA635 VJ me kapacitet mbajtës 17.1 ton dhe mjeti me targa AA963 MX me kapacitet mbajtës 16.5 ton. Asnjë nga mjetet e deklaruara nuk përmbush kapacitetin prej 10-15 ton. Si përfundim ky kriter konsiderohet i papërmbushur.

- Në pikën 2.3.12 të të Kriteve të Vecanta të Kualifikimit është kërkuar:

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Kamionçina me kapacitet mbajtës 3.5 - 5 ton	2 copë	Pronësi ose me qera

Për të përmbushur këtë kriter operatori ekonomik “Fled” shpk ka dorëzuar dokumentacion për mjetin me targa AA713 RO me kapacitet mbajtës nën 3.5 ton ; Kamionçina me targa AA719 UD me kapacitet mbajtës nën 3.5 ton ; Kamionçina me targa AA 216 YX me kapacitet mbajtës nën 3.5 ton ; Kamionçina me targa AA 541 UV me kapacitet mbajtës nën 3.5 ton ; Kamionçina me targa AA 648 XL me kapacitet mbajtës nën 3.5 ton. Asnjë nga mjetet e deklaruara nuk përmbush kapacitetin prej 3.5-5 ton. Si përfundim ky kriter konsiderohet i papërmbushur.

- Për autobotin e ujit me targa AA062 LV nuk është dorëzuar çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme), si dhe foto e mjetit në kundërshtim me pikën 2.3.12 të Kriteve të Kualifikimit në të cilat kërkohet: **Gërma “a”** Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik; d) siguracion mjeti, (i vlefshëm); e) *çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme)*. **Gërma “e”** Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të treguara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.
- Nuk ka dorëzuar foto për rrulin me vibrim
- Kuti e ndihmës së shpejtë nga 15 të kërkuara ka dorëzuar dokumentacion për 12 kuti të ndihmës së shpejtë.

### 3. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë –“Jogi”sh.p.k &”General Beton” sh.p.k,për arsyt :

Nga ana e Komisionit të Vleresimit të Ofertave konstatohet se ky BOE **nuk** ka dorëzuar në SPE gjithë dokumentacionin lidhur me kualifikimin tekniko-ligjor të kërkuar në Kriteret e Përgjithshme dhe të Vecanta të Kualifikimit të përkrahura në DST, si më poshtë:

- Anëtari “General Beton” shpk nuk ka dorëzuar vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2018 për bashkinë Fier, Vlorë dhe Patos.
- BOE nuk plotëson kriterin për dy kamioncina me kapacitet mbajtës 3.5-5 ton. Ka dorëzuar dokumentacion për kamioncinën me targa AA250YN e cila ka kapacitetin mbajtës 0.8 ton, si dhe për kamioncinën me targa FR9632C e cila ka kapacitetin mbajtës 2.8 ton, për kamioncinën me targa FR3137D e cila ka kapacitetin mbajtës 1.25 ton , për kamioncinën me targa AA744VN e cila ka kapacitetin mbajtës 7.75 ton.
- Nuk përmbush kriterin për katër automakinistë , ka dorëzuar dokumentacion për tre automakinistë, njërit prej të cilëve i ka përfunduar afati i vlefshmërisë së dëshmisë së aftësisë profesionale.

### 4. Shoqëria- “Spektri”sh.p.k, për arsyt :

Nga ana e Komisionit të Vleresimit të Ofertave konstatohet se ky OE **nuk** ka dorëzuar në SPE gjithë dokumentacionin lidhur me kualifikimin tekniko-ligjor të kërkuar në Kriteret e Përgjithshme dhe të Vecanta të Kualifikimit të përkrahura në DST, si më poshtë:

- Nuk ka dorëzuar dokumentacion për një mjek në kundërshtim me pikën 2.3.6 të Kriterëve të Vecanta të kualifikimit në të cilën është kërkuar : “Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Liçense për ushtrimin individual të profesionit, diplomë, të kete kontrat pune dhe të figuroje e listpagesat e shoqërisë të pakten muajin e fundit, 1 (një) mjek të përgjithshëm”.Për këtë arsye ky kriter konsiderohet i papërbushur.
- Për teknikun e ndërtimit nuk është dorëzuar dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve në kundërshtim me pikën 2.3.8 të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit.
- Ka dorëzuar dokumentacion vetëm për dy automakinistë ,nga katër automakinistë të kërkuar, në kundërshtim kjo me pikën 2.3.9 të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit
- Nuk plotëson kriterin për dy kamioncina me kapacitet mbajtës 3.5-5 ton.Ka dorëzuar dokumentacion për kamioncinën me targa AA692 SG e cila ka kapacitetin mbajtës 2.6 ton, si dhe për kamioncinën me targa AA687NV e cila ka kapacitetin mbajtës 1.5 ton, së cilës gjithashtu I ka përfunduar edhe afati i vlefshmerisë së kontrollit teknik dhe siguracioni i mjetit.
- Nuk përmbush kriterin për një kamion me kapacitet mbajtës 10-15 ton.Ka dorëzuar dokumentacion për kamionin me targa AA167BG me kapacitet mbajtës 16.8 ton, për kamionin me targa AA877ZB me kapacitet mbajtës 8.1 ton dhe kamionin me vinc me targa FR4887D me kapacitet mbajtës 9.1 ton.Sic shihet asnjë nga tre kamionët nuk ka kapacitetin 10-15 ton sic është kërkuar në Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, e si i tillë ky kriter konsiderohet I papërbushur

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, **informojmë - Shoqërinë-“Ina” sh.p.k** , me adresë Rruga Besim Imami, Myslym Shyri, Mbrapa Karburantit , Tiranë, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **6 056 240 (gjashtëmilionë e pesëdhjetë e gjashtëmijë e dyqind e dyzetë)lekë, pa TVSH**, pikët totale të marra [\_\_\_\_], është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Bashkisë Gramsh**, Bulevardi “10 korriku”, Sheshi “Kamber Dërmynshi “ , pranë Njesisë së Prokurimit, kati tretë, kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [\_\_\_\_], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 30.07.2020.

**Ankesa:** Më datë 03.08.2020 me nr.2800 prot regjistrohet në bashkinë Gramsh ankesa e operatorit ekonomik të skualifikuar “Fled” sh.p.k. Komisioni i Shqyrtimit të ankesës krijuar me urdhërin nr.245 datë 03.08.2020 vendosi të mos e pranojë ankesën dhe me shkresën nr.2900/2 datë 04.08.2020 ”Kthim përgjigje ankesës”, njofton ankimuesin lidhur me vendimmarrjen e Autoritetit Kontraktor, shkresë të cilën e dërgon edhe në formë elektronike më datë 04.08.2020

në Sistemin e Prokurimit Eletronik. Më datë 14.08.2020 përfundoi afati i ankesave në Komisionin e Prokurimit Publik dhe rezultoi se nuk pati ankesë drejtuar këtij komisioni

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**KRYETARI  
KLODIAN TAÇE**

Konceptoi: E.Guzi

Miratoi: E.Guzi

Dosja nr: \_\_\_\_\_

Afati i ruajtjes: \_\_\_\_\_